

RIGENERA

SMALTO ME BAZË UJI BI-KOMPONENTE PËR RINOVIMIN E PLLAKAVE DHE SHUMË SIPËRFAQE TË BRENDSHME

Seri 873

PËRSHKRIMI

Finiturë për shumë sipërfaqe, ideale në pllaka, kuti dushi dhe lavamanë, elemente metalike, laminate, mobilje dhe aksesorë arredimi.

Rinovon ambientet në mënyrë të lehtë dhe të shpejtë, pa qenë nevoja e një përgatitjeje specifike të sfondit/nënshtresës.

Realizon finiturë me gjysmë-shkëlqim uniforme dhe ekstremisht rezistente ndaj gërvishtjeve dhe shkeljeve me këmbë. Finiturë e përshtatshme për lyerjen e garazheve të makinave dhe garazheve private. Përbërja epokside, l jep rezistencë të lartë kimike ndaj detergjentëve normal shtëpiakë.

Konform me kërkesat e Reg. CE 852/2004 në higjienën e produkteve ushqimore.

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

E aplikueshme në sipërfaqe të brendshme, në:

- Suva gëlqereje dhe çimento
- Sipërfaqe qeramike
- Sanitare
- Lamine
- Sipërfaqe metalike
- Lëndë plastike
- Dru

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

RIGENERA është produkt bi-komponent.

-Komponenti A: rezinë epokside në tretësirë ujore

-Komponenti B: katalit në tretësirë ujore

-Solventi: ujë

-Dendësia UNI EN ISO 2811-1:

Komponenti A bardhë=1,38±0,05 kg/l.

Komponenti A transparente=1,25±0,05 kg/l

Komponenti B=1,05±0,05 kg/l.

-Aspekti: gjysmë-shkëlqim

-Kohëzgjatja: 2 orë në 20 °C

-Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R (L.R)): prekja pas 4 orësh; shtresa tjetër pas 24 orësh dhe jo më vonë se pas 48 orësh.

-Klasifikimi Cilësia e Ajrit të Brendshëm (Indoor Air Quality): A+

-Konform me HACCP sipas kërkesave të Reg.CE 852/2004.

PËRGATITJA E SIPERFAQES

Sipërfaqe suvaje:

-Sigurohuni që sipërfaqja të ketë një kohë maturimi prej të paktën 28 ditësh.

-Kontrolloni gjendjen e sipërfaqes. Sipërfaqja duhet të jetë e qëndrueshme. Në të kundërt, siguroni konsolidim me produkte specifike.

-Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, ndotjet e pranishme.

-Në prani të bojrave të vjetra, hiqni pjesët e cifikosura dhe jo të mirë aderuara, ndërsa pjesët e ngritura të bojës në gëlqere ose temperave, duhet të hiqen komplet, duke e larë sipërfaqen me ujë të bollshëm dhe duke e fërkuar ose duke përdorur makineri zmerilimi, pastrimi.

-Niveloni parregullsitë e sipërfaqes. Çarjet, plasaritjet, dhe vrimat në sipërfaqet e brendshme mund të trajtohen me BETOMARC 9450150 ose RASAMIX 9440160 ose me produkte me bazë çimentoje.

-Zmeriloni çarjet e stukuara me letër zmerile.

-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim.

-Në prani të mykut, trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (l cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).

-Në sipërfaqe të thatë vazhdoni me aplikimin e RIGENERA sipas udhëzimeve të përshkruara. Sipërfaqe të tjera: aplikoni RIGENERA në sipërfaqe të pastra dhe të thara. Para aplikimit, sipërfaqet trajtohen si vijon:

-Qeramikë, pllaka, laminate: pastrim I saktë l sipërfaqeve me detergjentë me përdorim shtëpiak.

-Metale hekuri: heqja e yndyrnave sipërfaqësore me dyljentët e posaçëm, zmerilim, trajtim me produkte specifike të tipit PRIMER 1630307 në zonat që paraqesin ndryshk.

-Metale jo hekur, alumin dhe lamierë e xinguar: Heqja e yndyrnave të sipërfaqes.

-Dru, PVC, lëndë plastike: opakizoni sipërfaqet me Scotch Brite (sfungjer) ose letër zmerile 1000.

UDHËZIME PËR APLIKIM

-Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:

Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C

Lagështira relative e ambientit: <75%

Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C

Lagështira e sipërfaqes: <10%

-Kohët e tharjes dhe punueshmërisë influencohen shumë nga temperatura: në temperatura të ulëta kohët zgjaten, ndërsa në temperatura të larta shkurtohen.

RIGENERA

SMALTO ME BAZË UJI BI-KOMPONENTE PËR RINOVIMIN E PLLAKAVE DHE SHUMË SIPËRFAQE TË BRENDSHME

Seri 873

- Aplikoni produktin në një ambient që të mos ketë pluhur.
- Shkalla e mbulimit: 10-12 m²/l për shtresë dhe l referohet sipërfaqeve lisho dhe mesatarisht absorbuese. Është mirë të përcaktohet konsumi me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.
- Mënyra e aplikimit:
Mjetet: pinel, rrull me qime të shkurtra, rrull me sfungjer extrafine, spruco.
Shtresat: 2.
Raporti I katalizës në volum: 1,6 pjesë nga komponenti A + 1 pjesë nga komponenti B
Raporti I katalizës në peshë: 100 g komponent A + 48 g komponent B
Holloni me ujë përzierjen e përftuar (A+B): 10% për aplikimet me pinel dhe rrull; 30% për aplikimet me spruco.
Shembull aplikimi me pinel dhe rrull: (0,5 L nga komponenti A + 0,3 L nga komponenti B) shtoni 80 ml ujë.
Shembull aplikimi me pinel dhe rrull: (100 g nga komponenti A + 48 g nga komponenti B) shtoni 12 g ujë.
Shembull aplikimi me spruco: (0,5 L nga komponenti A + 0,3 L nga komponenti B) shtoni 240 mL uje.
Shembull aplikimi me spruco: (100 g nga komponenti A + 48 g nga komponenti B) shtoni 36 g ujë.
Për lëndët plastike përdorni raportin e mëposhtëm të katalizës: 100 g Komp. A + 60 g Komp. B
-Mos shtoni më shumë ujë për të zgjatur jetëgjatësinë.
-Përzieni (katalizoni) dhe përdorni një paketim për një herë (komp. A + komp. B).
-Për të shmangur formimin e hijeve, aplikoni produktin në vazhdimësi, duke shmangur kalimin e rrullit ose pinelit në sipërfaqen e ljer kur produkti fillon të ngjisë/aderohet.
-Mjetet duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me ujë.
-Produkti mund të mbivendoset me vetveten.
-Respektoni me domosdoshmëri raportet e përzierjes.
-Respektoni kohët e tharjes para kalimit të shtresës tjetër.
-Rezistencat kimike dhe mekanike arrihen pas 7 ditësh nga aplikimi.

NGJYROSJA

Komponenti A është I disponueshëm në versionin e bardhë (0019) dhe bazë transparente (0062) , të dy të ngjyreshëm me Sistemin Tintometrik.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30°C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5°C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte temperature të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. A/j: bojë bi-komponente me performancë të lartë (bazë uji): 140 g/l (2010)
Produkti përmban max: 30 g/l VOC
Shkakton irritim të lëkurës. Shkakton irritime të rënda okulare. Mund të shkaktojë reaksion alergjik të lëkurës.
Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe stokohet/magazinohet sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos l hidhni mbetjet në ambient l lini të thahen komplet dhe l trajtoni ato si mbetje të veçanta. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Smalto me bazë uji, bi-komponent, për rinovimin e pllakave dhe sipërfaqeve të shumta brenda. Aplikimi, në sipërfaqe të predispozuara, për finiturë epokside bi-komponente me bazë uji RIGENERA seri 873, në të paktën 2 shtresa, me një konsum minimal prej 180 ml/m². Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.